

**RELACION SHPJEGUES**  
**PËR**  
**PROJEKT-LIGJIN**  
**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 55/2015 “PËR INVESTIMET STRATEGJIKE**  
**NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË NDRYSHUAR”**

Qëllimi i projektligjit është miratimi i një ndryshimi në ligjin nr.55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Me anën e këtij ndryshimi synohet zgjatja e afatit të paraqitjes së kërkesave nga subjektet investuese të interesuara për përfshirjen në procedurat për përfitimin e statusit “Investim/ investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë”, në zbatim të ligjit nr.55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, deri më datën 31 dhjetor 2020.

Me anën e këtij ndryshimi synohet zgjatja e afatit të paraqitjes së kërkesave nga subjektet investuese të interesuara për përfshirjen në procedurat për përfitimin e statusit “Investim/investitorstrategjik, procedurë e asistuar/e veçantë”, në zbatim ligjit nr 55/2015, deri në datën 31 dhjetor 2020.

Afati aktual i zbatimit të ligjit 55/2015 është data 31 dhjetor 2019.

Jam i informuar Ministria e Financave dhe Ekonomisë po punon për një projektligji të ri “Për investimet”. Duke qënë se ky projektligjit nuk do të arrijë të miratohet e të hyjë në fuqi deri më datë 31 dhjetor 2019, rrezikohet që të krijohet boshllëk ligjor. Për shmangur pasojat e këtij boshllëku ligjot propozoj që afati i zbatimit të ligjit të shtyhet deri më datë 31 dhjetor 2020.

Shtyrja me një afat prej një viti mundëson gjithë kohën e nevojshme të iterit qeveritar dhe parlamentar të diskutimit, miratimi dhe fillim it të zbatimit të ligjit të ri “Për investimet” që citova më sipër.

Në nenin 1 është përcaktuar se në nenin 36, të ligjit nr.55/2015, fjalët “... data 31 dhjetor 2019 ...” zëvendësohen me fjalët “... data 31 dhjetor 2020 ...”.

Zbatimi i këtij projektligji kërkon angazhimin si deri më tani të të AIDA, të Komitetit të Investimeve Strategjike, si dhe institucioneve dhe organeve të administratës shtetërore.

Projektligji nuk kërkon fonde shtesë.

